



KUVENDI I KOMUNËS **KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA**

Procesverbal i mbajtur më 28 qershor 2022, në mbledhjen e V-të (pestë) mandati VII-të i Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit në ndërtesën e re të Komunës, dhe filloi në orën 10;15.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht i këtij Komiteti.

Fillimisht u konstatua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti: Naim Çunaku, Arnisa Sylejmani, Adelinë Stublla, Florent Hasani, Sebastina Vokrri, Bashkim Sylja dhe Mrika Thaçi, ndërsa mungoi Qëndrim Softolli.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm ishin edhe; Marigona Lahu Nënkyetare e Komunës, Fatlum Osmani U.D. drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, Vigan Salihu U.D. drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik-DPZHE, Pajtim Balaj U.D. drejtor i Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit-DKRS, Avni Fetahu U.D. drejtor i Drejtorisë së Arsimit-DKA, Fatmir Rudari U.D. drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Pyltarisë dhe Zhvillimit Rural-DBPZHR.

Rendi i ditës

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen duke i përshëndetur të pranishmit dhe duke iu dëshiruar mirëseardhje dhe punë të mbarë në këtë mbledhje. Konstatoi kuorumin dhe ftoj nëse ka të interesuar për të marrë fjalën sa i përket pikave të rendit të ditës.

z.Pajtim Balaj, U.D. drejtor i DKRS, theksoi, së pari kërkoj falje sepse po më duhet ta bëj një propozim në këtë mbledhje që të hyj si pikë e rendit të ditës, propozim ky që nuk ka mund të hyj si pikë e rregullt e rendit të ditës por për shkak të disa problemeve sa i përket pronës dhe Drejtorisë së Planifikimit Urban Mbrojtjes së Mjedisit derisa i kemi sqaruar të gjitha dhe kemi ardhë në përfundim që ky propozim sot të kaloj si pikë e rendit të ditës dhe të kaloj për diskutim në seancën e radhës së Kuvendit, fjala është për propozim vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e pishinës së mbyllur gjysmë olimpikë. Ministria e Kulturës planifikon ndërtimin e 7 pishinave të tilla anë e mbanë Kosovës, fatmirësisht disa komuna më të mëdha se Podujeva i kanë pishinat dhe qendrat e tyre rekreative sportive, kështu që unë besoj se është një mundësi e mirë për Komunën e Podujevës si më e madhja me territor dhe komuna e 7-të për nga numri i banorëve në nivel vendi, që të jetë përfituese e njëjës prej këtyre pishinave e që vlera e tyre e përafërt është 1,500,000.00€ për ndërtimin e një pishine.

Kanë qenë disa lokacione që i kemi menduar mirëpo për shkak të vështirësive të planifikimeve në Hartën Zonale kemi ardhë në përfundim ta caktojmë lokacionin për të cilin jeni njoftuar në bazë të materialit të cilin ua kemi sjellë/shpërndarë, ky lokacion është më i përshtatshmi e që bëhet fjalë për

pjesën e qytetit afër magjistrales Podujevë-Prishtinë, afër ish hotel Besianës. Është pronë e Komunës dhe sipas planifikimit zonal është e mundur të ndërtohet ai objekt aty.

Besoj se objekti si i tillë është në të mirë të sportistëve, të klubeve të notit, zhytësve por edhe të komunitetit, shkollave dhe Komunës në përgjithësi dhe e rritë vlerën e vendit tonë në shumë aspekte. Propozoj që ky propozim të hyj si pikë shtesë e rendit të ditës dhe të kaloj në Kuvend për diskutim.

z.Avni Fetahu, U.D. drejtor i DKA, theksoi, posa ju shpërnda një kërkesë që bëhet fjalë për përfshirje në kuadër të rendit të ditës për shqyrtim dhe rekomandim pastaj në Kuvendin e Komunës e që ka të bëjë me ndryshimin e statusit të dy shkollave të mesme “Isa Boletin”, dhe “Fan S. Noli”, në status Institucion i Arsimit dhe Aftësimi Profesional - IAAP, dhe kjo nënkupton që vitet e ardhshme të ketë ndryshime të drejtimeve e që ky ndryshim i statusit mundëson që të hapen edhe drejtime që i kërkon tregu i punës.

znj.Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës, theksoi, edhe unë kam një propozim për përfshirje në rendin e ditës për shqyrtim dhe pastaj të rekomandohet për seancën e radhës të Kuvendit që mbahet ditën e enjte, dhe ka të bëjë me raportin e performancës së Komunës së Podujevës për vitin 2020.

Përmes këtij propozimi tentojmë që bëjmë një praktikë e cila është kërkuar në vlerësimin e performancës së komunave, kështu që kërkoj nga ju që ta votoni propozimin për përfshirje në kuadër të rendit të ditës si pikë shtesë edhe raportin e performancës së Komunës së Podujevës për vitin 2021.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, edhe unë kam një propozim që të përfshihet si pikë e rendit të ditës zëvendësimi i dy anëtarëve të Komitetit për Komunitete për arsye se dy anëtarë të këtij Komiteti kanë dhënë dorëheqje, fjala është për z.Muhamet Sadiku nga radhët e komunitetit rom i cili ka dhënë dorëheqje dhe në vend të tij është bërë kërkesë dhe është propozuar të zëvendësohet nga z.Selver Rama, si dhe znj.Albina Avdiu e cila ka dhënë dorëheqje nga radhët e komuniteti ashkali e cila ka dhënë dorëheqje por që është kërkuar dhe propozuar të zëvendësohet nga znj.Naile Ahmeti nga po i njëjti komunitet.

Pra propozimet për zëvendësime janë sjellë nga komunitetet përkatëse, përkatësisht janë sjellë kërkesat përkatëse me nënshkrimet e asaj pjese të cilët i përfaqësojnë., andaj kërkoj nga ana juaj që të përfshihet si pikë shtesë edhe kjo çështje si dhe të bëhen këto dy zëvendësime, përndryshe ai Komitet mund edhe të vazhdoi ashtu siç është me 7 anëtar/e aktualisht, mirëpo konsideroj se është mirë që të bëhen këto zëvendësime në mënyrë që të gjitha komunitetet t'i kenë përfaqësuesit e tyre në këtë Komitet dhe mos të kemi pengesa ligjore pastaj, kështu që propozoj që kjo pikë të hyjë si pikë shtesë e rendit të ditës.

z.Naim Çunaku, theksoi, ne kemi ardhë në mbledhje të KPF-së, mirëpo tani po na ofrohen më shumë pika të rendit të ditës se sa që kanë qenë të parapara sipas thirrjes dhe materialit të kësaj mbledhje, është shumë normale që urgjenca e disa pikave të bën që edhe të ndryshoj rendi i ditës mirëpo tani të propozohet që të ndryshohet rendi i ditës me 4 pika shtesë po më duket praktikë jo e qëlluar.

Munda ta kuptoj shumë mirë propozimin e drejtorit të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit që ai propozim mund të trajtohet me urgjencë ndoshta, mund ta kuptoj edhe situatën që gjendemi në fazën e regjistrimit gjegjësisht të përfundimit të vitit shkollor dhe përgatitje së fillim vitit të ri shkollor dhe sa kuptova nga drejtori i DKA-së kemi të bëjmë me arsimim më cilësor dhe më të mirëfilltë prandaj duhet të bëhet ndërrimi i statusit të dy shkollave edhe ky propozim mund të kaloj, mirëpo të diskutohen raporti i performancës dhe ajo që ti i nderuari Kryesues e propozove për zëvendësimin e anëtarëve të Komitetit për Komunitete, mendoj se këto dy pika apo propozime është mirë të shtyhen për një seancë të rregullt dhe të jenë pjesë integrale e thirrjes së mbledhjes, përndryshe në këtë aspekt do të thoja se mund të dalim shumë jo profesional ngase nuk e di si mund të diskutohet raporti i performancës së Komunës brenda kësaj mbledhje apo qoftë edhe mbledhjen e Kuvendit brenda kësaj periudhe të shkurtër.

Me gjithë respektin znj.Nënkryetare, kur raporti i performancës tashmë është praktikë në të gjitha komunat përjashtoj komunën tonë që se ka pasë asnjëherë dhe se ka diskutuar asnjëherë në Kuvend, nuk jam i kënaqur me raportin e performancës së Komunës tonë, kurse a ka pasë përparim apo jo, apo mund

të jetë e para dhe të përfitoj grande shtesë për nevojat e qytetarëve, por nuk mund të hyjmë në materie sepse nuk kemi çfarë të diskutojmë për këtë raport kur nuk kemi material për këtë seancë.

Unë konsideroj që raporti i performancës, të shtyhet deri atëherë kur e kemi edhe raportin e auditimit për seancën e ardhshme sepse të dyja ndërlidhen me njëra tjetrën dhe nuk ka qenë keq ta fusim edhe një praktikë të re që se keni pasë që nuk është publikuar kurrë raporti i auditimit të brendshëm ngase ky raport i paraprinë raportit të auditimit të jashtëm, në mënyrë që t'i kanalizojmë edhe njohuritë tona se si është menaxhuar paraja publike. Kështu që unë mendoj se propozimi i drejtorit të DKRS-së për ndërtimin e pishinës dhe propozimi i drejtorit të DKA-së për ndryshimin e statusit të dy shkollave të mesme mund të përkrahen, ndërsa propozimi për zëvendësimin e anëtarëve të Komitetit për Komunitete dhe propozimi për raportin e performancës të tërhiqen si propozime, përndryshe nëse shkojmë në votim bllok-për të gjitha përnjëherë, unë detyrohem të votoj kundër.

znj. Adelinë Stublla, theksoi, edhe ne si Grup i asamblistëve të LVV-së, jemi për t'i përfshirë dy pikat e para sipas propozimeve përkatëse në rend të ditës.

Meqë për propozimin për pikën e propozuar nga Nënkryetarja e Komunës nuk kemi material, gjithashtu edhe për propozimin e Kryesuesit për zëvendësimin e dy anëtarëve të Komitetit për Komunitete, ne nuk kemi material dhe nuk kemi të servuar kurrfarë emrash, kështu që mendojmë se në seancën e radhës do t'i diskutojmë këto tema dhe do të kemi materialin e nevojshëm sikurse që na është sjellë materiali nga drejtorët e DKA-së dhe DKRS-së, për të cilat kemi për çka të bisedojmë.

Kryesues i Komitetit, theksoi, për pikën që propozova unë, material tjetër nuk ka përveç dy dorëheqjeve nga anëtarët e cekur si dhe dy kërkesave me nënshkrime për zëvendësim, mirëpo nëse ju nuk e mbështetni këtë propozim atëherë unë e tërheq.

znj. Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës, theksoi, sa i përket raportit të performancës së Komunës për vitin 2020 keni të drejtë sepse materialin nuk e keni, mirëpo unë materialin e kam dërguar me kohë te Zyra e Kryesuesit të Kuvendit por që ka ndodhur një gabim teknik dhe nuk është përfshirë si pikë e rendit të ditës me thirrjen e kësaj mbledhje, dhe rrjedhimisht nuk ju është dërguar materiali përkatës, prandaj unë kam insistuar shumë që me qenë si pikë e rendit të ditës ky raport pasi që për seancat tjera kemi pika tjera të rendit të ditës të cilat dalin nga raporti i performancës, kështu që fundja mbetet vota juaj që vendos, mirëpo kisha pas dëshirë që ky propozim të kaloj.

z. Bashkim Sylja, theksoi, realisht është mirë që të ndalet kjo praktikë që të shtohet rendi i ditës me pika shtesë, ne e kuptojmë që mund të ketë ndonjë pikë të rendit të ditës që është me urgjencë, por sa i përket kësaj mbledhje unë sot i përkrahi të gjitha propozimet e bëra, kurse për mbledhjet e radhës është mirë që të ndalet kjo praktikë.

Kryesues i Komitetit, theksoi, edhe unë jam për ta ndaluar këtë praktikë por po na vijnë propozime që pa tjetër po duhet t'i fusim në procedurë të votimit si pika të reja të rendit të ditës. Realisht ne këtë praktikë mund ta ndalim nëse ky Komitet do t'i mbante mbledhjet 7 ditë pune para mbajtjes së mbledhjeve të Kuvendit dhe do të kishim mundësi për diskutime, mirëpo do të ishte një bllokim për drejtorët e Drejtorive sepse nuk do të kishin mundësi të propozonin pika të reja në mbledhjen e KPF-së, pra do të ishte pengesë. Sot dy drejtorët e dy Drejtorive përkatëse që i bënë propozimet e tyre nuk do ta kishin atë mundësi, kështu që ne mund të vendosim që t'i mbajmë mbledhjet e KPF-së 7 ose 10 ditë pune para mbajtjes së mbledhjes së Kuvendit, materiali dhe thirrja do t'ju dërgohej asamblistëve dhe për ne puna do të lehtësohej.

znj. Adelinë Stublla, theksoi, ne i cekëm këto pikat të cilat ne i kundërshtuam sepse nuk janë të arsyeshme të hyjnë si pika shtesë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, atëherë i vë në votim të gjitha propozimet e bëra veç e veç, si propozime që të hyjnë si pika të reja në kuadër të rendit të ditës, dhe atë sipas radhës së paraqitjes së propozimeve.

- Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se njëzëri nga 8 anëtar/e të KPF-së sa ishin prezent u përkrahë që të përfshihet në kuadër të rendit të ditës **propozim vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Pishinës gjysmë Olimpikë në Podujevë**, sipas materialit përkatës të shpërndarë anëtarëve të Komitetit.

- Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se njëzëri nga 8 anëtar/e të KPF-së sa ishin prezent u përkrahë që të përfshihet në kuadër të rendit të ditës **propozimi i Drejtorisë së Arsimit për ndryshimin e Statusit të SHMLT “Fan S. Noli” dhe SHMLE “Isa Boletini” nga Shkolla të Mesme të Larta Profesionale-SHMLP në Institucione të arsimit dhe Aftësisimit Profesional-IAAP**, sipas materialit përkatës të shpërndarë anëtarëve të Komitetit.

- Pa votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se meqë vetëm 2 vota ishin Për, kurse 6 vota ishin Kundër, nuk mbështetet propozimi i Nënkryetares së Komunës për përfshirje në kuadër të rendit të ditës për këtë mbledhje dhe rekomandimi për mbledhjen e Kuvendit të Komunës **Raportin e Performancës së Komunës së Podujevës për vitin 2020**.

- Pas votimit Kryesuesi i Komitetit konstatoi se meqë vetëm 2 vota ishin Për, kurse 6 Kundër, nuk përkrahet kërkesa e Kryesuesit të Kuvendit për përfshirje në kuadër të rendit të ditës dhe rekomandimin për mbledhjen e Kuvendit, **për zëvendësimin e dy anëtarëve/eve të Komitetit për Komunitete**, pas dhënies së dorëheqjes nga dy ish anëtarët znj. Albina Avdiu dhe z. Muhamet Sadiku, respektivisht zëvendësimin e tyre me të propozuarit përkatës sipas propozimeve të komuniteteve përkatëse

Kryesuesi i Komitetit, e hedh në votim rendin e ditës në tërësi, sipas thirrjes së kësaj mbledhje si dhe 2 pikave shtesë që u përkrahen paraprakisht.

Pas votimit Kryesuesi i Komitetit konstatoi se njëzëri nga 8 anëtarë/e sa ishin prezent në sallë, miratohet rendi i ditës sipas thirrjes së kësaj mbledhje, materialit përkatës si dhe duke përfshirë edhe dy pikat shtesë, dhe atë;

- **Propozim Vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Pishinës gjysmë Olimpikë në Podujevës** (renditet në pikën 5 të rendit të ditës)
- **Propozimi i Drejtorisë së Arsimit për ndryshimin e Statusit të SHMLT “Fan S. Noli” dhe SHMLE “Isa Boletini” nga Shkolla të Mesme të Larta Profesionale-SHMLP në Institucione të arsimit dhe Aftësisimit Profesional-IAAP** (renditet në pikën 6 të rendit të ditës)

1. Korniza Afatmesme Buxhetore 2023/2025 e Komunës së Podujevës.

z.Fatlum Osmani, U.D. drejtor i DBF, e paraqiti fjalën hyrëse rreth Kornizës Afatmesme Buxhetore – KAB 2023-2025, ndër të tjera theksoi, në bazë të ligjit për financat publike, gjatë muajit qershor të gjitha Komunitatet janë të obliguara që të përgatitin Kornizën Afatmesme Buxhetore ku paraqiten orientimet strategjike për investimet e Komunës për vitet 2023-2024-2025. Ky dokument është hartuar në përputhje me Qarkoren e parë Buxhetore të lëshuar nga Ministria e Financave ku parashihen limitet buxhetore të Komunës së Podujevës ku për vitin 2023 kemi një rritje të buxhetit afër 4,000,000.00€ në krahasim me buxhetin e vitit 2022, gjithashtu kemi rritje progresive për vitet 2024- 2025, ku në vitin 2025 arrin një buxhet në vlerë prej 30,293,000.00€.

Për këtë Kornizë janë mbajtur disa dëgjime publike në bashkëpunim me të gjithë dhe besoj se kemi arrit të një dokumenti i cili i përgjigjet kërkesave dhe nevojave të përgjithshme, andaj nga ana e anëtarëve të KPF-së kërkoj që ta rekomandojnë për diskutim dhe aprovim në mbledhjen e Kuvendit komunal.

z.Florent Hasani, në emër të Grupit të këshilltarëve të LVV-së, theksoi, e përkrahim këtë pikë të rendit të ditës dhe e rekomandojmë për shqyrtim në Kuvendin e Komunës.

Meqë nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, Kryesuesi e hedhi në votim këtë pikë të rendit të ditës që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se njëzëri nga 8 anëtar/e të KPF-së sa ishin prezent, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim.

2. Propozim vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit - Çerdhe Publike në hapësirën e SHFMU “Xheladin Rekalu” në Podujevë.

z.Avni Fetahu, U.D. drejtor i DKA, e paraqiti fjalën hyrëse rreth këtij propozim vendimi, ndër të tjera theksoi, nga Ministria e Arsimit na ka ardhë një thirrje përmes projektit IPA-3, që parasheh edhe ndërtimin e një Çerdheje tjetër në Komunën e Podujevës, kështu që na është kërkuar me vendos në Kuvend komunal këtë propozim në mënyrë që të merret përkrahja juaj, andaj edhe presim një gjë të tillë.

znj.Sebastina Vokrri, në emër të Grupit të këshilltarëve të LVV-së, theksoi, e mbështesim dhe e përkrahim këtë pikë të rendit të ditës që të kaloj dhe të rekomandohet për seancën e radhës në Kuvend.

Meqë nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, Kryesuesi e hedhi në votim këtë pikë të rendit të ditës që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se njëzëri nga 8 anëtar/e të KPF-së sa ishin prezent Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim.

3. Propozim vendimi për vënie në diskutim publik:

- Arsyeshmëria profesionale për shpalljen e zonës “Ushton Lumi” në Popovë si zonë të mbrojtur të natyrës;
- Elaborati: Studimi për arsyeshmërinë profesionale për marrjen në mbrojtje të vlerës së natyrës: “Trungu i Qarrit” (quercus cerris), në fshatin Lupç i Poshtëm.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, këto janë dy monumente natyrore që Drejtoria e Planifikimit Urban Mbrojtjes së Mjedisit i ka paraparë që të jenë si monumente të mbrojtura me ligj që të mos dëmtohen, qoftë kjo zona / lugina lumore në fshatin Popovë, qoftë trungu i qarrit në fshatin Lupç i Poshtëm. Materiali është sjellë me kohë dhe sigurisht e keni lexuar, është një elaborat që e sqaron mirë këtë çështje edhe pse nga Drejtoria përkatëse nuk është prezent askush për të dhënë sqarime dhe shpjegime, mirëpo ky është propozim për vënie në diskutim publik.

z.Florent Hasani, në emër të Grupit të këshilltarëve të LVV-së theksoi, e mbështesim këtë iniciativë por kam edhe një pyetje për Nënkryetaren e Komunës pasi që drejtori i DPUMM-së nuk qenka prezent, në pjesën e liqenit të Batllavës që po ndodhin shumë ndërtime dhe mbi ndërtime dua ta di se a ka investigim nga ana e Komunës apo ndonjë analizë të situatës në terren si dhe a janë duke u bërë shkelje urbanistike në atë zonë që duhet të jetë nën mbrojtje të ligjit.

znj.Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës, theksoi, në zonën e Batllavës realisht nuk lejohen ndërtime, pjesa e liqenit është e ndarë në 3 zona, zona e I-rë, zona e II-të dhe zona e III-të, Drejtoria e Inspeksionit ka ndërmarr masa dhe i kanë ndal punimet, kështu që momentalisht nuk e di se a është dikush duke bërë ndërtime apo jo, mirëpo inspektorët kanë dalë në terren, kanë fotografuar të gjitha ndërtimet dhe secili ndërtim i cili ka ndryshim prej momentit të fotografimit normalisht do të iniciohen procedurat gjyqësore, por besoj se zona e Batllavës është shumë më mirë se që ka qenë më parë.

Meqë nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, Kryesuesi e hedhi në votim këtë pikë të rendit të ditës që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se njëzëri nga 8 anëtar/e të KPF-së sa ishin prezent Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim.

4. Formimi i Komisionit për hartimin e draft Rregullores për Orarin e Punës së Bizneseve që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës.

z.Vigan Salihu, U.D. drejtor i DPZHE, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, ndër të tjera theksoi, si përfundim në mbledhjen e fundit të Kuvendit gjatë diskutimeve jemi dakorduar që të formohet një grup punues bashkërisht mes Ekzekutivit dhe Kuvendit për hartimin e një draft rregulloreje për orarin e punës për bizneset që operojnë në Komunën e Podujevës. Unë ju kam dërguar një propozim që grupi punues të përbëhet prej 9 anëtarëve prej tyre 5 anëtarë të jenë nga radhët e Kuvendit kurse 4 anëtar nga radhët e Ekzekutivit, mirëpo tani propozoj që ky grup punues të përbëhet prej 7 anëtarëve prej tyre 3 anëtar/e të jenë nga radhët e Kuvendit të Komunës dhe 4 anëtar/e të jenë nga radhët e Ekzekutivit të Komunës.

Meqë nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, Kryesuesi e hedhi në votim këtë pikë të rendit të ditës që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim.

Pas votimit Kryesuesi i komitetit konstatoi se njëzëri nga 8 anëtar/e të KPF-së sa ishin prezent, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim, me përkrahjen e propozimit që Komisioni në formohet prej 7 anëtarëve (3 anëtarë/e nga Kuvendi i Komunës dhe 4 anëtarë/e nga radhët e Ekzekutivit të Komunës)

5. Propozim Vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Pishinës gjysmë Olimpikë në Podujevës.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, sa i përket kësaj pike të rendit të ditës besoj se sqarimet u dhanë në hyrje të kësaj mbledhje nga ana e drejtorit të DKRS-së, mirëpo nëse ndokush dëshiron ta marrë fjalën urdhëroni nëse jo atëherë e vë në votim.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se njëzëri nga 8 anëtar/e të KPF-së sa ishin prezent Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim.

6. Propozimi i Drejtorisë së Arsimit për ndryshimin e Statusit të SHMLT “Fan S. Noli” dhe SHMLE “Isa Boletini” nga Shkolla të Mesme të Larta Profesionale-SHMLP në Institucione të arsimit dhe Aftësimit Profesional-IAAP

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, edhe për këtë pikë të rendit të ditës sqarimet po thuajse u dhanë në fillim të kësaj mbledhje nga Drejtori i DKA-së, nëse dikush nga ju dëshiron ta marrë fjalën urdhëroni nëse jo atëherë e vë në votim.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se njëzëri nga 8 anëtar/e të KPF-së sa ishin prezent Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim.

Kryesues i Komitetit e konstaton të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 10:50

**Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli**

**Nr.prot.01-060/04-0052552/22
Podujevë,
28 qershor 2022**

**Kryesuesi i Kuvendit - Komitetit
Hilmi Hoxha**